



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/55
Datë: 31.12.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 7 të Ligjit Nr. 04/L-177 për dërgimin e Forcës së Sigurisë jashtë vendit, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 07/2020, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 31 dhjetor 2020, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet kërkesa e Ministrisë së Mbrojtjes për bashkë-dërgimin e kontingjentit të Forcës së Sigurisë jashtë vendit me Gardën Kombëtare të Iowa-s, sipas ftesës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës.
2. I propozohet Kuvendit të Republikës së Kosovës marrja e vendimit për dërgimin e kontingjentit të FSK-së jashtë vendit me mision në ofrimin e mbështetjes për stabilitet rajonal dhe operacione paqeruajtëse në regionin e Komandës Qendrore Amerikane, U. S. Central Command (USCENTCOM).
3. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit për procedimin e vendimit për shqyrtim dhe miratim në Kuvendin e Republikës së Kosovës.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Avdullah HOTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/55
Datë: 31.12.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 29 të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, nenit 15 të Ligjit për Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2020, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 07/2020, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 31 dhjetor 2020, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet kërkesa e Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës për ndarjen e mjeteve financiare në shumë prej 100.000 euro, me qëllim të mbështetjes financiare për Republikën e Kroacisë pas tërmetit.
2. Mjetet nga pika 1. e këtij vendimi ndahen nga buxheti i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, OB- 216, kategoria mallra dhe shërbime kodit 28600.
3. Obligohet Ministria e Financave dhe Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës për zbatimin e këtij vendimi, nga ndarjet buxhetore të lejuara me Ligjin e Buxhetit për vitin 2021.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Avdullah HOTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë